




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr. Iq/B. str.	83
Data/Datum	26.06.2020
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS	



Datë: 26.06.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.06.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 464, të datës 15.06.2020, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2021 buxheti i komunës është në shumë prej: 11,263,819.00€;
 - 1.2 Për vitin 2022 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,555,971.00€;
 - 1.3 Për vitin 2023 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,852,415.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023 është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivit.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjushta





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 28.02.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.02.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 59, të datës 11.02.2020, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, nenin 14, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, paragrafi 1, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 4, nenin 5, nenin 10, nenin 11, nenin 12, të Udhëzimit Administrativ për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënim dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës Nr. 02/2018, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), nenin 54, shkronja (dh, f) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Propozimit Nr. 59, të datës 11.02.2020, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë për vitin 2020


1. Për miratimin e Propozimit Nr. 59, të datës 11.02.2020 për vazhdimin e taksave administrative të vitit 2019 për zbatim edhe në vitin 2020, caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2020 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.51€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.96€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - 1.3 Taksa administrative për leje të rrënit në shumë prej 0.89€ për një metër katror;
 - 1.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej 4.75€ për një metër katror.
2. Miratimi i taksave administrative dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2020, mbështetet në pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. 6646-2/19, të datës 16.12.2019.
3. Objektet publike institucionale që financohen nga institucionet shtetërore lirohen nga taksat për leje ndërtimore.

4. Llogaritja e taksave administrative për leje ndërtimore të kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë, leje të rrënit dhe tarifa për rregullimin e densitetit në infrastrukturë, bëhet duke u mbështetur në pikën një të vendimit.
5. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br. str.	69
Data/Datum.	10.06.2020
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE Fushë-Kosovë	



Datë: 09.06.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.06.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 398, të datës 19.05.2020, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 2, nenin 50, nenin 51, të Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim, të Projekt-Rregullores për organizimin e punës në Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkolla të Mesme të Larta

1. Për aprovimin në parim, të Projekt-Rregullores për organizimin e punës në Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkolla të Mesme të Larta, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës dhe kalimin e saj në procedurën e diskutimit publik.
2. Drejtoria e Arsimit, do të ofrojë informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik dhe institucionet arsimore, lidhur me këtë Projekt-Rregullore për organizimin e punës në Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkolla të Mesme të Larta në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, gjatë diskutimit publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARSIMIT dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRATIJU	
Nr./No. 73		
Data/Datum 10. 06. 2020		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		



Datë: 09.06.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.06.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 53, të datës 05.03.2020, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c, d), nenin 34, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 14, nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Sabit Bullatovci - Përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.2 Ilir Hasani - Përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Arjeta Jashari - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Durim Hajra - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.5 Arjana Zogiani - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar/e;
 - 1.6 Migjen Kolshi - Përfaqësuesi i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar;
 - 1.7 Mehdi Lahu - Përfaqësues i Partisë Social Demokrate, anëtar;
 - 1.8 Hysni Hasani - Përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, anëtar;
 - 1.8 Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, anëtar;
 - 1.10 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar dhe
 - 1.11 Maliq Thaçi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, nga pika një (1) e vendimit, është hartimi i Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 09.06.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.06.2020, pas shqyrtimit të Propozimit për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e personelit shëndetësorë vullnetarë që kanë punuar në kohën e pandemisë së Coronavirus-it COVID -19, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 3,000.00€ për pagesën e punëtorëve vullnetarë në shëndetësi që kanë punuar në parandalimin e Coronavirus-it COVID-19

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 3,000.00€, për pagesën e pesë punëtorëve vullnetarë në shëndetësi që kanë punuar dhe shërbyerë në parandalimin e Coronavirus-it COVID-19, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, për dy muaj me nga 300.00€ për secilin muaj kalendarik.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi prej kategorive ekonomike nga programet buxhetore të komunës, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë për Financa e Buxhet, sipas mundësive buxhetore të komunës, nëse këta punëtorë shëndetësorë nuk kompensohen me mjete financiare nga Ministria e Shëndetësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**

